



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republikë of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, dhe nenin 9, paragrafi 1, pika 7, të Udhëzimit Administrativ, Nr-27/2012, të nxjerr nga MPB-ja dhe Nr-03/2012, të nxjerr nga MAPL-ja me datën 22.08.2012, pas propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën, 10.02.2025 miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

MIRATOHET Plani Vjetor i Punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për periudhën janar-dhjetor për vitin 2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Veprimit për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën janar-dhjetor 2025, i hartuar nga Koordinatori i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në bashkëpunim me anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe i miratuar nga Kuvendi i Komunës në Dragash.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës njëherit Kryesues i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Koordinatori i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Dragash, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në web-faqën zyrtare të Komunës.

01Nr. 060/01-1810-5/25

Datë 10.02.2025



Kryesuesja e Kuvendit

A. Skeraj
Arijeta Skeraj